

**UNIVERSITETI I GJAKOVËS**  
**FAKULTETI I MJEKËSISË**

PROGRAMI MAMI



**PUNIM DIPLOME**

**TEMA: Ushqimi artificial të fëmijët**

**Kandidatja:**

**Laureta Muharremaj**

**Mentor:**

**Prof. Ass. Dr. Haxhi Kamberi**

Gjakovë 2018

## **Deklaratë studentore**

Unë, kandidatja; Laureta Muharremaj studente e Universitetit të Gjakovës - Fakultetit të Mjeksisë e zgjodha këtë temë me një përgjegjësi të madhe, andaj në përgatitjen e punimit te diplomës nuk kam lejuar qe punimi im të devijoj nga origjinaliteti. Me këtë dëshiroj të theksojë që i gjithë materiali i përfshirë në punim është i cituar dhe i listuar në referenca.

## **Falendërimet**

Për rezultatet e arritura deri më tani, falendëroj familjen time për mbështetjen që më dhanë në çdo aspekt dhe për të arritur deri në këtë stad,

Falendëroj profesorët dhe stafin udhëheqës të Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”.

Në fund, falendëroj edhe mentorin tim Prof. Ass. Dr. Haxhi Kaberi, i cili gjithmonë gjeti kohë për të më ndihmuar në realizimin e këtij punimi, andaj e falendëroj përzemërsisht për durimin, korrektësinë dhe këshillat e tij gjatë gjithë kësaj periudhe.

## **Përmbajtja:**

1 Abstrakti.....	5
2 Abstract.....	6
3. Hyrja.....	7
4. Metodologjia.....	8
5. Qëllimi i punimit.....	8

## **Kapitulli I :Rishikimi I literaturës.....9**

1.1 Ushqyerja artificiale e latantit.....	9
1.2 Qumështi i lopës.....	10
1.3 Bakteriologjia e qumështit të lopës.....	12
1.4 Llojet e bakterive në qumështin e lopës.....	12

## **Kapitulli II :Llojet e qumështave për ushqyerje artificiale të latanti.....13**

2.1 Qumështi industrial për latant.....	13
2.2 Qumështi komercial .....	14
2.3 Qumështi i freskët i lopës, i papërpunuar (nativ).....	15

## **Kapitulli III :Përgatitja në amvisëri i qumështit të papërpunuar(nativ) të lopës dhe qumështit komercial për ushqyerjen e latantit.....16**

3.1 Sasia, numri dhe orari i racioneve në ushqyerje artificiale.....	17
3.2 . Numri i racioneve në ditë dhe vëllimi mesatar i racioneve gjatë ushqimit me shishe, në vitin e parë të jetës.....	18
3.3. Ushqimi plotësues i latantit ( Ushqyerja shtesë, joqumështorë).....	18
3.4. Arsytet e dhënies së ushqimit plotësues latantit janë të shumta.....	18

## **Kapitulli IV**

### **Pasojat e padëshirueshme të dhënies së parakohshme të ushqimit plotësues.....19**

4.1 Ushqyerja e fëmijës të periudhës parashkollore dhe shkollore.....	19
4.2 Qrregullimet e ushqyeshmëris.....	20
4.3 Ushqimi i fëmijës së semurë.....	21
4.4 Ushqyerja enterale.....	21
4.5 Ushqyerja paraenterale (intravenoze).....	23
4.6 Përse disa nëna nuk t'u japin gjii foshnjave.....	25

<b>KAPITULLI V: .....</b>	<b>27</b>
5.1 Diskutimi.....	27
5.2 Përfundimi.....	28
5.3 Rekomandimet.....	29
5.4 Referenca.....	30
5.5 Biografi e shkurtë e kandidates (CV).....	31

## **ABSTRAKT**

Hyrja: Ushqimi artificial nënkupton ushqyerjen e latantit, me çfarëdo qumështi tjetër, përveq me qumështin e nënës. Ushqimi artificial, përdoret nëse nëna nuk ka gjë fare ose nëse femija ka indikacione që nuk mundë të ushqehet me qumësht gjiri.

Qëllimi: Qëllimi i kësaj teme është zgjerimi i njohurive lidhur me ushqimin artificial të fëmijëve, arsyet e këtij ushqimi si dhe mënyra dhe llojet e ushqimit artificial.

Metodologjia: Për realizimin e këtij punimi është përdorur metoda e rishikimit të literaturës, është shfrytëzuar literaturë e bollshme nga biblioteka e Fakulteti të Mjeksisë të Universitetit “Fehmi Agani”, si dhe literaturë tjetër shkëncore nga burime të ndryshme dhe interneti.

Perfundimi: Ushqimi i fëmijëve me qumështin e nënës, ka përparesi të padiskutueshme me llojet e tjera të qumështit. Por në rastet kur nëna nuk mundë ta ushqej fëmijen për arsye të ndryshme ushqimi me qumësht sipas formule është i domosdoshëm dhe bëhet në konsultim me mjekun.

Fjalë kyçe: Ushqim, Foshnje, Nëna, Qumësht artificial.

Punimi përfshin: faqe:31, tab:3, foto:2

## **Abstract**

Entry: Artificial feeding means latent feeding, with any other milk, except for mother's milk. Artificial food is used if the mother has no breast at all or if the child has indications that she can not breastfeed.

Purpose: The purpose of this topic is to expand the knowledge about the artificial feeding of children, the reasons for the use of this food as well as the ways and types of artificial food.

Methodology: For the realized of this topic, the method of reviewing the literature was used, the abundant literature was used by the library of the faculty of the University of Fehmi Agani, as well as other scientific literature from different sources and the internet.

Conclusion: Feeding children with mother's milk has an indisputable role with other types of milk. But in cases where the mother can not feed the baby for different reasons milk food according to the formula is indispensable and is done in consultation with the doctor.

Key words: Food, Baby, Mother, Artificial Milk.

The work includes: page: 31, tab: 3, photo: 2

# 1.Hyrja

Ushqimi artificial nënkupton ushqyerjen e latantit, me qfarëdo qumështi tjetër, përveq me qumështin e nënës. Ky ushqim tjetër më shpesh është qumështi lopës, qe më heret është vërejtur se vdekshmëria te fëmijët me ushqyerje artificiale ka qene më e shprehur se tek fëmijet me ushqim natyral. Edhe sot në disa vende është shume e shprehur kjo dukuri,sepse për shkak të varferisë dhe mos edukimit, ende nuk ka arritur ushqimi kualitativ bashkohor. Ushqimi artificial, plotësisht, përdoret nëse nëna nuk ka gji fare. Për ushqim përdorët, qumështi i lopës, në formë të preparateve industriale, sikurse edhe të ushqimi i përzier. Më ushqim artificial duhet të plotësohet nevojat energjetike, dhe ato, dukshëm dallojnë prej atyre të fëmijëve më ushqim natyral. Sesa i sukseshëm është ushqimi artificial, vlerohet në të njëjtën mënyrë, si te fëmijët që ushqehen me ushqim natyral nga dukja e jashtme, sjelljet e tij, vlerat e masës trupore, dhe të gjatësis. Një nga përfitimet e ushqimit te shisheve është se çdokush mund ta ushqejë foshnjën. Ushqimi është një moment i rëndësishëm lidhës, ndërmjet foshnjës dhe nënes. Ndërsa ushqimi i shisheve lejon vëllezërit e motrat, baballarët dhe anëtarët e tjerë të familjes që ta ndajnë këtë përvojë me fëmijën e sapolindur. Ndonjëherë ushqyrja me gji në publik mund ta vë në siklet një grua dhe ta bëjë atë të ndjehet e pasigurtë. Në këto situata, ushqimi i shisheve do të ishte gjëja më e mirë për të bërë. Ju mund ta ushqeni fëmijën tuaj pa pasur nevojë të ekspozoni gjinjtë në ndonjë mënyrë ose të shkoni në një zonë private për ushqyerjen me gji. Ushqimi i shisheve ju mundëson të ushqeni fëmijën tuaj në çdo kohë me lehtësi dhe efektivitet.



## **2. Metodologjia**

Për realizimin e këtij punimi është përdorur metoda e rishikimit të literaturës, është shfrytëzuar literaturë e bollshme nga biblioteka e Fakulteti të Mjekësisë të Universitetit “Fehmi Agani”, si dhe literaturë tjetër shkencore nga burime të ndryshme dhe interneti.

## **3. Qëllimi dhe objektivat**

Qëllimi i kësaj teme është zgjerimi i njohurive lidhur me ushqimin artificial të fëmijëve, arsyet e ushqimi artificial si dhe llojet dhe mënyra e të ushqyerit.

# Kapitulli I

## 1.1 Ushqyerja artificiale e latantit

Me ushqyerje artificiale nënkuptohet ushqyerja e latantit me çdo lloj qumështi tjetër përveq me qumështin e nënës. Më së shpeshti për ushqyerje artificiale përdoret qumështi i lopës. Semundshmëria dhe vdekshmëria e latanteve në ushqyerje artificiale gjithmonë ka qenë shumë herë më e lartë në krahasim me latantet në ushqyerje natyrale. Ky dallim është shume me i shprehur ne vendet me te pa zvuilluara dhe ne zhvillim, sepse ushqimi artificial kualitativ i përpunuar në mënyrë bashkëkohore, për shkak të varfëris dhe arsimimit të ulët shëndëtsor, është i paarritshëm për te gjitha shtresat e popullatës. Ne katër dhjetëvjjetshin e fundit në vendet e zhvilluara, është zhvilluar industria e gjerë për përpunimin e qumështit të lopës, i dedikuar vetëm për ushqimin e latantit. I përpunuar në kushte higjeinike, përdorimi i lehet në praktikë, risitë teknike dhe propagandimi i gjëre i formulave të qumështit ka pasur si rezultat rritjen e përqindjes së ushyerjes së latantëve në ushqyerje artificiale. Ushqyerja artificiale duhet të përdoret vetëm në rast të hipogalaksionit të nënes, ose kur ekziston kundërintikimi absolut i përhershëm nga ana e nënes dhe fëmijës për ushqyerje natyrale. Nëse për këto arsye latanti duhet të jetë në ushqyerje artificiale prej qumështit të gjitarëve të tjerë (dhisë, deles etj.), vështirë u përshtatet nevojave nutritive të latantit, prandaj përdorimi i qumështit të këtyre gjitarëve nuk preferohet për ushqyrjen e latantit.

## 1.2. Qumështi i lopës

**Veçoritë fizike.** Qumështi i lopës është lëng i bardhë me primesa të verdha (karotena) dhe të kaltra (vitamina B<sub>2</sub>), me shije të ëmbël, pa erë. Peshat specifike është 1.032-1.035, vlon në 101 C°, pika e ngrirjes është 0.53 C°, ka reaksion acidik (pH:6.5-6.9).

**Përbërja biokimike.** Qumështi i lopës është kompleks nutritiv që përmban ujë, proteina, yndyra, hidrate të karbonit, minerale dhe vitamina.

**Uji.** Përben sasinë më të madhe të qumështit 100 ml qumësht përmban 87.5 g ujë.

**Proteinat.** Qumështi i lopës përmban 3.2 g proteina në 100 ml qumësht. Proteinat përbëhen prej kazeinës (80%) dhe proteinave të hirrës (20%) prandaj qumështi i lopës quhet edhe qumësht kazeinik. Në sasi më të madhe gjëndet në formë të  $\alpha$ -kazeinës. Kazeina është fosfoproteinë me ndërtim micelar, e cila në qumësht ndodhet në formë të tretjes koloide të kazeinatit të kalciumit. Në lukth me veprimin e kimozinës bëhet koagulimi i tij. Koagulimi i formuar në krahasim me atë të qumështit të nënës, është i fortë, konsistencë të gomës, i përbërë prej fluskave të vrazhda dhe të mëdha, prandaj edhe më vështirë tretet. Proteinat e hirrës në sasi më të mëdha (9 %) përmbajnë  $\beta$ -laktoglobulina që supuzohet se është përgjegjëse për alergjinë në qumësht (reaksionet aergjike të latantit në qumësht të lopës). Përbërësit e tjerë janë  $\alpha$ -laktoalbumina dhe në sasi shumë të vogël laktoferina, lizozima, IgA sekretore dhe albuminat e serumit, të cilat në qumështin e nënës janë të pranishme në sasi më të mëdha (qumësht albuminik). Proteinat e qumështit të lopës përmbajnë të gjitha aminoacidet e njohura, por në sasi më të vogël se në qumështin e nënës, sidomos ato esenciale.

**Yndyrat.** Qumështi i lopës përmban 3.8 g yndyra në 100 ml qumësht. Pikëzat yndyrore janë me madhësi të ndryshme 10-25  $\mu$ g me predominim të pikëzave më të mëdha, të cilat janë më të lehta se uji, prandaj notojnë në sipërfaqen e qumështit. Emulsioni i yndyrave është johomogjen dhe jostabil. Yndyrnat e qumështit të lopës përbëhen prej tri glicerideve, fosolipide dhe acideve yndyrore të ngopura (stearik dhe palmitik), të cilat më vështirë treten dhe absorbohen. Sasia e acideve yndyrore të pangopura dhe kolesterolit është më e ulët në qumështin e lopës në krahasim me qumështin e nënës.

**Hidratet e karbonit.** Qumështi i lopës përmban 4.7 g hidrate të karbonit në 100 ml qumësht (më pak se në qumështin e nënës).

Laktoza, e cila përbëhet prej fraksionit  $\alpha$ -laktozës, është hidrati i karbonit kryesor në qumështin e lopës, por më pak shfrytëzohet nga latanti në krahasim me fraksionin e  $\beta$ -laktozës së qumështit të nënës. Përmbajtja e oligosakarideve në qumështin e lopës është minimale (0.01%), kurse nuk përmban fare faktorin bifidus të rëndësishëm për rritjen laktobacilus acidofilusit, i cili është përfaqësues kryesor i florës bakterore të zorrëve të fëmijët në ushqyerje natyrale.

**Mineralet.** Përmbajtja e mineraleve në qumështin e lopës është 0.7 g minerale në 100 ml qumësht ( afro tri herë më e madhe në krahasim me qumështin e nënës). Minerale të qumështin e lopës ndodhen më shumë në formën joorganike në krahasim me formën organike. Përmban më shumë klor, kalcium, natrium, kalium, magnez dhe fosfor. Përmbajtja më e lartë e proteinave dhe mineraleve në qumështin e lopës rrit ngarkesën osmotike të veshkave tri herë më shumë në krahasim me qumështin e nënës.

Oligoelementet. Me gjithë përmbajtjen e lartë të mineraleve, qumështi i lopës përmban pak hekur (0,018mg/100 ml qumësht), zink dhe bakër në krahasim më qumështin e nënës.

**Vitaminat.** Të gjitha vitaminat e njohura janë të pranishme në qumështin e lopes, por në sasi të ndryshme. Përmban sasi të pamjaftueshme të vitaminës D, acidit askorbik dhe acidit folik.

Vlera kalorike e qumështit të lopës është 65-70 kcal(272-293 KJ) në 100 ml qumësht.

### 1.3. Bakterologjia e qumështit të lopës

Qumështi i freskët (nativ, i papërpunuar) i lopës gjithmonë përmban baktere nga kanalëzat dalës të gjendrës së qumështit, lëkurës së lopës, duarve të personelit që manipulon më qumësht, enëve dhe prej ajri. Për shumimin e bakterive në qumësht rëndësi kanë temperaturat në të cilin ruhet qumështi, intervali kohor prej mjeljes deri tek ingestioni dhe niveli higjienik të të gjitha etapave nëpër të cilat kalon qumështi: higjienes së kultivimit të lopës, mjeljes, kullimit, ftohjes, zierjes enëve (paketimit) dhe temperaturës në të cilën ruhet qumështi. Menjëherë pas mjeljes, qumështi i lopës përmban rreth 3000-5000 baktere saprofite në 1 ml. Në temperaturë të dhomës, një orë pas mjeljes numri i bakterive arrin në 10.000, pas 3 orëve rreth 20.000, kurse 24 orë pas mjeljes arrin në rreth 5.000.000 bakterie në 1 ml qumësht. Sipas ligjeve sanitare qumështi për latant nuk duhet të përmbajë më shumë se 5000 bakterie saprofite në 1 ml, kurse numri i bakterive koliforme në 1 ml qumësht patjetër duhet të jetë negativ.

### 1.4. Llojet e bakterive në qumështin e lopës.

Qumështi i lopës i freskët i papërpunuar përmban bakterie saprofite, por mund të jenë të pranishme edhe bakteriet patogjene.

1. Bakteriet saprofite përbëhen prej tri grupeve:

a) Bakteriet saprofite sakarolitike: *Streptococcus lactis*, *Lactobacillus acidophilus* dhe *Lactobacillus bulgaricus*. Gjenden në numër më të madh (95%) të florës sakarolitike. Fermentojnë laktozën, duke formuar acidin laktik dhe acidin monoacetik dhe ngadalësojnë shumimin e bakterive saprofite proteolitike.

b) Bakteret saprofite proteolitike. *Clostridium subtilis*, *Clostridium perfringens* dhe *Clostridium Eelchii* gjenden në numër më të vogël, por potencialisht të rrezikshme për latantin. Këto bakterie bëjnë hidrolizën (tretjen) e proteinave të qumështit, duke krijuar substanca të dëmshme për traktin tretës të latantit (amoniakun dhe peptonet).

Shpejt shumëzohen në qumështin e pasterizuar i cili nuk përmban baktere sakarolitike.

c) Bakteret saprofite lipolitike: *Pseudomonas fluorescens*, *Achromobacter*, *Bacillus buturicus* etj. bëjnë hidrolizën e yndyrave gjer në trigliceride dhe acide yndyrore.

2. Bakteret patogjene mund të jenë me origjinë nga lopa e sëmurë: *Salmonella*, *M. tuberculosis*-tipus *bovinus*, *Brucella abortus* dhe *Streptococcus agalactis* ose me origjinë nga personi i sëmurë i cili manipulon më qumësht. *Salmonella*, *Shigella*, *Escherichia coli* patogjene etj.

Parandalimi i kontaminimit bakteror të qumështit të lopës përfshin kontrollimin e rregullt të lopëve nga ana e veterinarëve dhe kontrollimin shëndëtsor të personave, të cilët bëjnë mjeljen. Kujdes i veçantë duhet ti kushtohet transportit, shpërndarjes, ruajtjes në temperaturë të duhur, intervalit kohor prej mjeljes gjër te përdorimi dhe procedurave teknologjike (zierja, pasterizimi dhe sterilizimi i qumështit) para përdorimit të qumështit.

## **Kapitulli II**

### **Llojet e qumështit për ushqyerje artificiale të latantit**

Qumështi i lopës si qumështi më i shpeshtë për ushqyerjen artificiale të latantit në praktik mund të përdoret në tri forma:

1. Qumështi industrial për latantë (formulat e qumështit);
2. Qumështi komercial;
3. Qumështi i freskët (nativ) i lopës.

Nëse latanti është në ushqyerje artificiale me cilindo lloj të qumështit që përdoret për ushqyerje duhet ti plotësojë këto kushte: të mundësojë rritjen dhe zhvillimin e latantit, ngjashëm me latantin në ushqyerje natyrale, përbërësit biokimik të qumështit përafërsisht duhet të jenë të ngjashëm me përbërësit e qumështit të nënës, qumështit nuk duhet shtuar drithëra, thartësira, mjaltë etj. Qumështi nuk duhet të përmbajë materie toksike dhe mikroorganizma patogjenë, nuk duhet të përmbajë aditivë racioni i qumështit i përgatitur duhet me qenë izotonik dhe reaksionet alergjike, të shkaktuara nga qumështi, duhet të jenë minimale.

#### **2.1 Qumështi industrial për latantë (Ushqyerja e latantëve me përpunimet industriale të qumështit-formulat e qumështit)**

Qumështi industrial iu dedikohet për ushqim ekskluzivisht vëtem latantëve, të cilët, te kunderindikimet absolute të përhershme ose hipogalaksioni, janë zgjidhja më e mirë për ushqyerjen artificiale të latantit. Në mungesë të qumështit të nënës, qumështi industrial është qumështi më i mirë, dhe më i sigurt në aspektin bakteriologjik, i cili mund të sigurojë rritjen dhe zhvillimin normal të latantit. Veqorit e qumështit:

- Të gjitha llojet e qumështit industrial, në aspektin bakteriologjik, janë sterile
- Përbërja e materieve ushqyese është konstante, të përshtatura sipas moshës së latantit

- Gjatë procesit të prodhimit të tyre ndryshohet sasia dhe kualiteti i proteinave, yndyrave hidrateve të karbonit, mineraleve dhe vitaminave, me qellim që përmbajtja e tyre globale përafërsisht t'i afrohet përmbajtjes së qumështit të nënës.
- Qumështi industrial nuk përmban materie toksike (insekticide, pesticide, materie joni-zuse etj)
- Paketimi metalik i qumështit mund të ruhen në rezerva të qumështit për latantët në kushte jetësore të jashtëzakonshme (tërmetet, luftërat, vërshimet, epidemit etj).

#### **Anët negative të përdorimit të qumështit industrial janë:**

- Përdorimi dhe propagandimi i gjëre i qumështit industrial shkakton ndarjen e parakohshme të fëmijës nga ushqyrja natyrale pa ndonjë arsye
- Për shkak të ekzistimit të numrit të madh të llojeve të këtyre qumështit në treg, ndonjher shkakton konfuzion dhe e vështirëson zgjedhjen e llojit adekuat të qumështit për ushqyrjen e latantit
- Përgatitja e disa llojeve të qumështit industrial është e ndryshme, me përqendrim 10-20 g/100 ml ujë. Nëse nëna është me arsim të pamjaftueshëm shëndetsor, qumështi i përgatitur mund të jetë tepër i holluar, ose tepër i përqendruar
- Qdo qumësht industrial ka shijen e vet specifike, prandaj ndodh që preparati i qumështit të ndërrohet gjër në përshtatjen e shijes së fëmijës.
- Në aspektin ekonomik qumështi industrial e ngarkon buxhetin familjar (sidomos për vendet e pazhvilluara dhe vendet në zhvillim)

## **2.2. Qumështi komercial (përpunimi industrial i qumështit të lopës për përdorim të përgjithshëm dhe përdorimi i tij në ushqyerjen e latantit)**

Qumështi është ushqim shumë kualitativ dhe në tërësi mund t'i plotësojë nevojat e ushqimit për një moshë të caktuar. Mirëpo, është terren dhe ushqyes i mirë për rritjen dhe shumimin e baktereve. Prandaj, duhet ndërprerë shitjen e qumështit në kova drejtëpërdrejt prej prodhuesit, sepse nuk mund të garantohet kualiteti dhe moskontaminimi i qumështit. Për ushqyerjen e latantëve duhet përdoret vetëm qumështi i plotë, më plotë yndyrë, më përqendrim të yndyrës 3.5%, kurrsesi jo më pak se 3.2%. Qumështi komercial me përqendrim të yndyrës nën 3.2% nuk duhet rekomanduar për ushqyerjen e fëmijëve të shëndoshë. Në varshmëri nga mënyra e përpunimit industrial ekzistojnë disa lloje të qumështit komercial: Qumështi i pasterizuar, qumështi i sterilizuar afat shkurtër, qumështi pluhur me plot yndyrë,

qumështi i evaporuar ( qumështi i dëndësuar) Qumështi i kondensuar (i ëmbelsuar)

### 2.3 Qumështi i frëskët, i papërpunuar (nativ) i lopës

Qumësht i freskët i papërpunuar i lopës është qumështi i pazier, menjëherë pas mjeljes. Ky qumësht në këtë formë nuk duhet të përdoret për ushqyerjen e latantit, për shkak se vështirë tretet në traktin trëtes dhe ka mundësi të madhe të kontaminimit me baktere patogjene. Në familjet fshatare është burim i shpeshtë për ushqyerjen e latantit. Veqorit e tij bakteriologjike varen prej standardit higjienik të familjes, pas mjeljes duhet të ruhet në frigorifer, kurse para përdorimit duhet të zihet. Për shkak të realizimit të lehtë dhe arsyeve ekonomike mund të përdoret për ushqyerjen e latantit me përgatitje dhe përshtatje paraprake.

Mangësitë e qumështit të lopës të papërpunuar janë :

- Përqendrimi i lartë i proteinave me predominim të kazeinës
- Përfshirja e lartë e triglicerideve me acide yndyrore të pangopura
- Përqendrimi i ulët i laktozës
- Përqendrimi i lartë i natriumit dhe raporti i disfavorshëm i kalciumit dhe fosforit për absorbimin e tyre
- Deficiti i oligoelementeve,
- Deficiti i vitaminave A, D, C
- Osmolariteti i lartë.

Nëse latanti ushqehet më qumësht të pa-përpunuar të lopës,paraqiten këto ndërlikime: deficiti kalciumit, tetania, rakiti, anemia sid-eropenike, hipernatremia dhe intoleranca në proteina të qumështit.



## Kapitulli III

### **Përgatitja në amvisëri e qumështit të papërpunuar (nativ) të lopës dhe qumështit komercial për ushqyerjen e latantit**

Qumështi i papërpunuar (nativ) i lopës dhe komercial për ushqyerje të latantit para përdorimit duhet t'iu nënshtrohet disa procedurave. Këto janë:

**1 Zierja e qumështit.** Më këtë procedurë arrihet shkatërrimi i mikroorganizmave patogjenë, shumica e sporeve të tyre dhe shumica baktereve saprofite. Bëhet denaturimi i proteinave, duke u përmirsuar tretja e tyre, sepse kazeina e qumështit në lukth koagullohet në koagulumë më të buta, më të imët dhe më poroz dhe më lehtë i nënshtrohet tretjes nga ana e enzimave dhe sekreteve të lukthit. Gjithashtu me zierje të qumështit zvogëlohen vetitë alergjene të tij. Çdo racion të qumështit para çdo ushqyerje të latantit duhet zier, "sterilizimi i drejtepërdrejtë". Kohëzgjatja e zierjes varet prej mënyrës paraprake të ruajtjes dhe paketimit të qumështit. Zakonisht duhet zier 3-5 minuta.

**2 Hollimi i qumështit.** Qumështi i lopës përmban më shumë proteina dhe kripëra në krahasim më qumështin e nënës, ai është i koncentruar - përqendruar dhe është ushqim me osmolaritet të lartë për veshkat e latantit, prandaj duhet holluar atë. Hollimi i qumështit është i dobishëm dhe për plotësimin e nevojave të latantit për ujë. Tek i porsalinduri hollimi i qumështit bëhet me sasi të barabartë të ujit (1:1) - qumështi i lopës i përgjysmuar. Prej fillimit të muajit të dytë gjer në mbarim të muajit të gjashtë, në dy sasi të qumështit shtohet një sasi uji - dy të tretat e qumështit (2:1). Pas muajit të gjashtë qumështi i lopës duhet t'i jepet latantit si qumësht i plotë (i paholluar). Hollimi i qumështit bëhet me ujë të pijshëm të vluar, ose më lëngun e orizit me përqendrim të orizit 1-3 %. Përparsitë e hollimit të qumështit me lëngun e orizit qëndrojnë në shijen më të mirë të qumështit, rritjen e vlerës kalorike, materiet mukus, hymnia dhe pektina si pjesë përbërse të lëngut të orizit kanë veprim antidiarrok dhe gjithashtu mukusi i lëngut të orizit e zvogëlon vrazhdesinë e koagulimit kazeinik dhe stimulon zhvillimin e florës bakterore sakarolitike të qumështit.

### **3 Shtimi i sheqerit (sakrozës) dhe hidrateve tjera të karbonit( ëmbëlsimi i qumështit)**

Qumështi i lopës ka shije të këndshme, por është më pak i ëmbël në krahasim më qumështin e nënës, sepse përmban më pak hidrate të karbonit. Më hollimin e tij zvogëlohet vlera kalorike dhe shija tij. Për këtë arsye qumështit të lopës duhet shtuar sheqer. Zakonisht i shtohet disakardi sakrozë (sheqer i rëndomtë) NË PËRQENDRIM 5 % (5 g sheqer në 100 ml qumësht). Përveq sakarozës mund të shtohen edhe polisakaride me përqendrim 2 % ( lëngu i orizit ose fjollat e orizit) kurse më vonë mund t'i shtohen edhe amidoni grurit dhe misrit)

### Për përgatitjen e 300 g qumësht

Duhet	Qumësht të përgjysmuar	Dy të tretat qumësht	Qumësht i plotë
Qumështi lopës më plot yndyra	150 g	200 g	300 g
Ujë	150 g	100 g	
Sheqer (Sakrozë)	15 g	15 g	15g
Polisakaride	5 g	5 g	5 g

### Për përgatitjen e 600 g qumësht

Duhet	Qumësht të përgjysmuar	Qumështi -2 pjese qumësht 1pjese ujë
Qumështi lopës më plot yndyrna	300 g	400 g
Ujë	300 g	200 g
Sheqer (Sakrozë)	30 g	30 g
Polisakaride	10g	10 g

### 3.1. Sasia, numri dhe orari i racioneve në ushqyerje artificiale

Ushqyerja e parë e fëmijës me ushqim artificial fillon në të njëjtën kohë sikur edhe ushqyerja natyrale. Sasia e qumështit në ushqyerje artificiale është e kufizuar, kurse nevojat energjike të latantit janë të njëjtat me nevojat energjike të tij gjatë ushqyerjes natyrale. Sasia e qumështit nuk varet prej fëmijës, por prej nënës. Fëmija nuk duhet detyruar të pijë nëse nuk dëshiron, sepse ekziston rreziku i mbipeshës. Sasia dhe numri i racioneve jepen sipas moshës së fëmijëve:

- Dita parë e jetës 10-20 ml kulloshtër,
- Sasia e qumështit gjer në fund të javës së parë përcaktohet në bazë të formulës së Finkelstein-it

### **3.2. Numri i racioneve në ditë dhe vëllimi mesatar i racioneve gjate ushqimit me shishe, në vitin e parë të jetës**

Mosha	Numri i racioneve	Vëllimi i racioneve
Deri 7 dite	6-10	10-70 ml
2-4 jave	6-8	70-100ml
2 muaj	6	100-130 ml
3 muaj	6	130-160 ml
4 muaj	5-6	160-190 ml
5-6 muaj	4-5	150-220ml
7-12 muaj	4-5	200-250 ml

### **3.3. Ushqimi plotësues i latantit ( Ushqyerja shtesë, joqumështorë)**

Më ushqim plotësues nënkuptohet ushqyerja e latantit me çdo lloj ushqimi tjetër përveq qumështit. Në kuptimin e ngushtë ushqimi plotësues është plotësimi gradual dhe më vonë zëvendësimi i racioneve me qumësht me ndonjë ushqim tjetër. Nevojat për ushqim plotësues të latantit paraqiten dhe rriten gradualisht, sepse qumështi i nënës dhe i lopës nuk i plotësojnë nevojat me disa materie ushqyese (p.sh. vitaminë C, D dhe hekur ), kurse pas muajit të gjashtë të jetës nuk i plotëson nevojat edhe me dendësinë kalorike. Fillimi i përdorimit të ushqimit plotësues varet prej moshës së latantit, nevojave nutritive, gjendjes ekonomike të familjes, shprehive të ushqyerjes së familjes, arsimimit shëndetësor të nënave, vlerës nutritive të artikullit ushqimor dhe shkallës së zhvillimit të aftësive psikomotorë të fëmijës në lidhje me marrjen e ushqimit. Në intervalin kohor 4-6muajsh, qumështi nuk është i mjaftushëm si ushqim i vetëm për latantë. Në këtë moshë zhvillimi psikomotorik i fëmijës arrin atë shkallë të zhvillimit që latanti mund ta përtypë dhe ta gëlltisë ushqimin e qulltë.

### **3.4. Arsytet e dhënies së ushqimit plotësues latantit janë të shumta:**

1. Nutritive, sepse qumështi nuk mund t'i sigurojë nevojat nutritive dhe energjike,
2. Faktori social (inkuadrimi në punë jashtë shtëpisë mëndeshës),
3. Me marrjen e ushqimit të forte latanti mësohet ta përtypë dhe ta gëlltisë ushqimin,
4. Adaptimi i latantit me shije tjetër të ushqimit, përveq shijes së ëmbël të qumështit,
5. Ushqimi plotësues është burim i mjaftushëm i vitaminave C, D dhe vitaminave të kompleksit B, hekurit dhe proteinave me origjinë animale

## **Kapitulli IV**

### **Pasojat e padëshirueshme të dhënies së parakohshme të ushqimit plotësues.**

Nëse ushqimi plotësues jepet para muajit të pestë, gjegjësisht të shtatë të jetës së latantit, mund të paraqiten pasojat e padëshirueshme, siç janë:

1. Ushqimi plotësues përmbanë mjaft klorur të natriumit (NaCl), prandaj mund ta rrisë ngarkesën osmolare të veshkave.
2. Rritja e osmolaritetit të plazmës, i cili shkakton dehidrim hipernatremik, etje, duke shkakuar rritjen e shtuar dhe marrje të qumështit dhe energjisë që për pasojë ka mbipeshën (adipozitetin).
3. Në muajtë e parë të jetës imuniteti lokal i zorrëve nuk është i përsosur dhe dhënia e ushqimit tjetër, përveq qumështit mund të shkaktojë reaksion alergjik, sidomos vezët, domatja, portokalli, peshku etj.
4. Në tre muajt e parë të jetës, karota dhe spinaqi mund të shkaktojnë methemoglobinemi për shkak të përmbajtjes të sasisë së madhe të nitrateve.

#### **4.1. Ushqyerja e fëmijës të periudhës parashkollore dhe shkollore**

Në fillim të vitit të dytë fëmija fillon vetë të ushqehet, të pijë nga gota dhe ta përdorë lugën. Për dallim prej moshës së të rriturve, te të cilët nevoja për ushqim janë relativisht stabile, të fëmijët gjer në fund të adoleshencës, për shkak të rritjes dhe zhvillimit, nevojat për ushqim dhe energji të fëmijës varen prej aktivitetit fizik, moshës, kushteve klimatike, nevojave për rritje, zhvillim dhe nevojave individuale, pasi që ekzistojnë dallime individuale ndërmjet fëmijëve, duke marrë parasysh faktorët konstitucionalë si dhe shpejtësinë, ritmin e rritjes dhe zhvillimit të fëmijës. Ushqyerja e fëmijës parashkollorë dhe shkollorë duhet me qenë optimale. Rritja e masës trupore dhe lartësisë në këto periudha është konstante dhe më e ngadalshme në krahasim me periudhen e latantit (përrjashtim nënë peridha e pubertetit ku kemi fazën e shpejtuar të rritjes), zvogëlohen nevojat për materie energjike dhe ndërtesuese (përveq periudhës së pubertetit). Në fund të vitit të dytë të jetës së fëmijës pason pjekuria e plotë e traktit tretës dhe të veshkave. Prandaj, fëmija pas kësaj moshe mund të konsumojë ushqimin e zakonshëm për të rritur. Pas vitit të parë qumështi e humb prioritetin si ushqim kryesor i fëmijes dhe duhet kshilluar prindërit që sasia ditore e qumështit të mos kalojë sasinë e 500 ml. Përveq qumështit mund të përdoren edhe prodhimet fermentative të qumështit siq janë: jogurti, kosi dhe djathi. Për shkak të vlerës së ulët kalorike të përmbajtjes së ulët të acideve yndyrore, qumështi i kremzuar (pa mazë) nuk u rekomandohet fëmijëve gjer në fund të vitit të pestë të jetës.

Yndyrnat duhet të sigurojnë 30 % të vleres kalorike të tërësishme të menysë së fëmijës pas vitit të parë. Përmbajtja e triglicerideve me acide yndyrore të pangopura duhet të jetë 10% kurse e treglicerideve me acide yndyrore të ngopura nën 10 % të vlerave kalorike të tërësishme të ushqimit. Për shkak të rrezikut nga aspirimi, gjer në vitin e katërt nuk duhet të vihen pranë fëmijës lajthitë, arrat, farat e ndryshme dhe bonbonet.

Më qellim të parandalimit të paraqitjes së problemeve në ushqyerjen e fëmijës pas vitit të parë ekzistojnë disa **parime**:

1. Lloji i ri i ushqimit duhet të futet gradualisht në menynë e fëmijës;
2. Fëmija duhet të zgjedhë llojin e ushqimit si pas dëshirës dhe shijes, nuk duhet detyruar fëmijën që të ushqehet nëse nuk dëshiron;
3. Duhet pasur durim gjatë bisedës me fëmijën lidhur me marrjen e ushqimit;
4. Duhet dhënë racione të vogla dhe të inkurajohet për ngrënie;
5. Nëse dëshiron duhet t'i jepet ende i njëjti ushqim;
6. Racionet dhe zamrat, sipas mundësisë t'i jepen qdo ditë në të njëjtën kohë;
7. Zamrat mos të jepen para racionit kryesor;
8. Nuk duhet të insistohet me qdo qmim për ta ngrënë zamrën fëmija.

Pediatria: Mehmedali Azemi & Mujë Shala fq.349

## 4.2. Qrregullimet e ushqyeshmëris

Termin qrregullim i ushqyeshmëris e ka përdorur në shekullin e kaluar pediatri gjerman Adalbert Cezerny, që përfshin të gjitha sëmundjet akute dhe kronike të fëmijës, të cilat pengojnë shtimin normal të masës trupore.

**Përkufizimi.** Me qrregullime të ushqyeshmërisë nënkuptohen të gjitha gjendjet morbide të cilat shkaktojnë pengesa në ushqyerjen e fëmijës dhe kurrsesi jo vetëm ato gjendje që paraqiten për shkak të ushqyerjes joadekuate. Të këto gjendje fëmija nuk është mirë i ushqyer dhe ka shmangie të masës trupore nga fëmija në të njëjten moshë në gjendje eutrofike.

**Klasifikimi.** Të gjitha gjendjet patologjike që paraqiten për shkak të ushqyerjes jo adekuate kronike ndahen në tri grupe. Këto mund të manifestohen me shenja dhe simptoma klinike, kurse disa mund të diagnostifikohen vetëm me analiza biokimike dhe me matje antropometrike:

1. Nënushqyeshmëria proteino-energjiqe,
2. Mbipesha (adipoziteti)
3. Sëmundjet specifike deficitare (hipovitaminozat dhe deficieti i oligoelementeve).

### **4.3. Ushqyerja e fëmijës së sëmurë**

Qëllimi i shërimit të fëmijës së sëmurë është ruajtja e proceseve normale të metabolizmit që realizohet me sigurimin e oksigjenit dhe të materieve ushqyese në qeliza dhe në inde. Për realizimin e tillë, krahas mbështetjes së funksioneve të frymemarrjes dhe atyre kardiovaskulare, e domosdoshme është që fëmijës t'i sigurohen marrja e materieve gjegjëse ushqyese. Ushqimit të fëmijës së sëmurë, në dhjetëvjetëshin e fundit po i kushtohet rëndësi e madhe.

Ushqyerja e fëmijës së sëmurë mund të realizohet përmes këtyre mënyrave:

1. Ushqyerjes enterale,
2. Ushqyerjes paraenterale (ushqyerja intravenoze),
3. Ushqyerjes me disa lloje të posaqme të ushqimit për fëmijët e sëmurë.

### **4.4. Ushqyerja enterale**

Përkufizimi. Ushqyerja enterale është furnizimi i organizmit me materie ushqyese nëpërmjet sondës ose stomës drejtpërdrejt në lukth, ose në zorrë, në rastet kur marrja natyrale e ushqimit nëpërmjet gojës nuk është e mundshme, sepse i sëmuri nuk mund të hajë me gojë ose është e mundshme, por është e pamjaftueshme për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Parakusht për përdorimin e ushqyerjes enterale është ruajtja e funksioneve tretëse dhe absorbtive të traktit tretës. Mënyra alternative e ushqyerjes, në rastet kur ushqyerja enterale është e vështirsuar, është ushqyerja paraenterale:

#### **Përparsitë e ushqyerjes enterale**

- Ushqyerja enterale është mënyrë e ushqyerjes më natyrale, më fiziologjike dhe më e sigurt.
- Është me e thjeshtë për përdorim, më e lirë dhe më ndërlikime më të rralla
- Me ushqyerje enterale ruhet integriteti struktural dhe funksional i zorreve, për shkak të prezencës së ushqimit në zorrë. Tek ushqyerja paraenterale zvogëlohet masa e zorrës së hollë për shkak të hipoplazisë dhe atrofisë së vileve të enterociteve si dhe zvogëlimit të aktivitetit të disakaridazave.
- Te ushqyerja enterale materiet ushqyese absorbohen në traktin tretës, me qarkullim portal në melqi u nënshtrohen proceseve metabolike, duke i stimuluar funksionet dhe metabolizmin e zorreve të melqisë, kurse ushqimi total paraenterale qrrregullon sekretimin normal të enzimeve dhe të hormoneve të traktit tretës.

- Rekomandimet e nevojave ditore për materiet ushqyese tek ushqyerja enterale llogariten më lehtë dhe më saktë

## **Indikimet për ushqyerjen enterale totale**

### **1. Sëmundjet që shkaktojnë nënushqyeshmëri të rënd proteino-energji**

Sëmundjet e traktit trëtes që shkaktojnë malabsorbim

- Diarreja kronike
- Koliti ulqeroz
- Sëmundja Crohn
- Refluksi gastroezofageal

### **2. Sëmundjet kronike të organeve të tjera**

- Sëmundjet kronike të mushkërive;
- Fibroza cistike;
- Sëmundjet e mëlqisë;
- Anomalitë e lindra të zemrës;
- Tumoret malinje;
- Sëmundjet e rënda të veshkave.

### **3. Gjendjet që pamundësojnë marrjen e ushqimit**

- I porsalinduri para kohe;
- Anoreksia nervoze;
- Qrregullimet e thithjes dhe gëlltitjes.

### **4. Sëmundjet neurologjike**

- Gjendjet komatoze të prolonguara;
- Paraliza celebrale;
- Sëmundjet neurologjike me pengesa të ushqyerjes.

### **5. Sëmundjet kirurgjike të traktit tretës**

- Obstruksioni i pjesëshem i traktit tretës;
- Atrezia e rrugëve bilare;
- Traumat e rënda;
- Sindroma e zorrës së shkurter ;
- Keqformimet e hapsirës së gojës (cheliognatopalatoschisis).

## **4.5. Ushqyerja paraenterale (intravenoze)**

**Përkufizimi.** Ushqyerja paraenteral është procedurë me të cilën materiet ushqyese futen në organizëm nëpërmjet venave dhe është mënyrë alternative e marrjes natyrale së ushqimit (nëpërmjet gojës ose ushqyerjes enterale ( me sondë ose stomë). Konsiderohet ndër zbulimet më të rëndësishme të mjekësisë bashkëkohore. Në praktiken pediatrike përdoret në 35 vjetët e fundit. Ushqyerja paraenterale mund të aplikohet si :

**1.** Ushqyerja paraenterale parciale. Një pjesë e materive ushqyese merren në rrugën orale ose enterale, kurse pjesa tjetër në rrugën paraenterale. Duhet shfrytëzuar të gjitha mundësit që një pjesë e ushqimit të merret në rrugë orale ose enterale, sepse ushqimi në zorrë stimulon tretjen, peristaltiken dhe regjenerimin e epitelit të zorrëve.

**2.** Ushqyerja paraenterale totale me kohëzgjatje të shkurtër.

**3.** Ushqyerja paraenterale totale me kohëzgjatje të gjatë. Të gjitha materiet ushqyese merren vetëm me rrugë paraenterale. Ushqyerja totale paraenterale aplikohet në rastet kur, për shkaqe të ndryshme, ushqyerja orale dhe enterale është e pamundur dhe marrja e ushqimit me këto rrugë rrezikon jetën e fëmijës (atrezia e ezofagut, gastroschisa, fistulat, gastrointestinale etj ). Ushqyerja paraenterale duhet maksimalisht t'iu përshtatet nevojave të fëmijës së sëmure për nga përmbajtja dhe sasia. Duhet të sigurojë mjaft energji për metabolizëm bazal, ripërtëritjen e indeve trupore, funksionet ekskretore normale, mbajtjen e ekuilibrit termik dhe kryerjen e aktiviteteve fizike. Të gjitha këto kërkesa të organizimit realizohen nëse nuk sigurohet raporti adekuat i materive ushqyese: hidrateve të karbonit, proteinave, yndyrnave, ujit, elektroliteve, oligoelementeve dhe vitaminave.

### **Indikimet për ushqyerje paraenterale.**

#### **1. Sëmundjet e traktit tretës:**

Vjellja kronike;

Diareja kronike autoimune;

Atrofia e lindur e mikrovileve të zorrëve;

Pankreatiti akut;

Enterokoliti nekrotizues i të porsalindurit;

Sëmundja Crohn;

Koliti ulçeroz;

Omfalocela, gastroshiza, atrezia e ezofagut;

Sindroma e zorrës së shkurtër;

Obstruksioni kronik i zorrëve;

Malrotacioni i zorrëve.



2. **Sëmundjet e organe të tjera**  
Pamjaftueshmëria e mëlqisë;  
Pamjaftueshmëria e veshkave.
  
3. **Gjendjet kirurgjike jashtë traktit tretës**  
Mbështetja paraoperative;  
Mbështetja postoperative;  
Traumat;  
Djegiet.
  
4. **Anoreksia nervosa**
  
5. **Sëmundjet malinje ( pas rrezatimit të barkut)**
  
6. **I porsalinduri në masë të vogël trupore (< 1200 g).**
  
7. **Gjakrrjedhjet intrakraniale**
  
8. **Sindroma e distresit respirator**
  
9. **Anomalit e lindura të metabolizmit të aminoacideve**
  
10. **Fibroza cistike**

#### 4.6. Përse disa nëna nuk u japin gji foshnjave

Ka shumë gra të cilat dëshirojnë t'i japin gji bebes, por nuk kanë mundësi. Disa prej tyre nuk kanë qumësht të mjaftushem, mendojnë se bebes qumështi nuk i bën mirë apo gjatë rritjes bebja nuk do të ketë qumësht të mjaftueshëm. Kryesisht gratë e dinë se qumështi i nënës është ushqimi i pazëvendësueshëm për bebet e tyre, andaj edhe dëshirojnë t'u japin gji. Kjo gjë te shumica tyre nuk ka sukses, për shkak që në fillim dekurajohen, mungon stimulimi i mjaftushem i sisës ose shumë herët i japin bebes ushqim artificial. Ekzistojnë vështërsi objektive gjatë ushqimit më qumësht të nënës, si p.sh. dhembja dhe pelcitja e thithmave, thithma të rrafshët dhe të futura brenda, inflamacioni i gjinjëve, të cilat nënat e reja nuk dinë si t'i kapercejnë dhe ia ndërpresin bebes gjirin. Ato ditë të para është me rëndësi që nëna të pushojë, të hajë dhe të pijë mjaftushem dhe sa më shpesh bebes t'ia ofrojë sisën. Është shumë me rëndësi ushqimi me gji natën , sepse mundësojnë stimulimin më të mirë dhe rrjedhje më të madhe të qumështit. Në qoftë se pesha e bebes vazhdimisht dhe shumë bie, mjeku do të rekomandojë plotësimin me ushqim të bebës. Jini të sigurt që mjeku nuk do të ngutet nëse konstaton se jeni të gatshme ta ushqeni beben tuaj me gji.



Ndërsa nese e ushqeni foshnjen me ushqime artificial bebja aq me pak do e pranojë gjirin e nënes pastaj.

<https://telegrafi.com/perse-disa-nena-nuk-mund-tu-japin-gji-foshnjave/>



Fëmija dhurata e me qmuar në jetë

<https://telegrafi.com/perse-disa-nena-nuk-mund-tu-japin-gji-foshnjave/>

## 5.1 DISKUTIMI

Nëse nëna nuk mundët, apo nuk don që fëmiut ti jep gji, atë duhet udhëzuar ne menyren me të mire për dhenien e ushqimit artificial, megjithate ne fillim duhet insistuar nga ana e personelit mjeksor që ti tregohet për përparsit e gjidhënies, mirpo nëse nëna veqse ka vendosur për ushqimin e fëmijës me shishe, atehere ajo nuk duhet ngarkuar me ndjenjen e fajit. Gjatë zgjedhjes se ushqimit artificial, perveq keshillave mjeksore, rol me rendesi luajnë edhe tradita familjare, niveli i arsimimit etj. Ushqimi artificial është një zgjedhje e mire si për nënën ashtu edhe për foshnjën, sepse nuk është aspak i demshëm mund ta ushqejmë foshnjën në të njejtën mënyre si më qumësht gjiri. Për ushqyerjen artificiale duhet kshilluar qdo nënë e re e cila ende nuk posedon informata adekuate për ushqyerjen artificiale se i plotëson të njejtat nevoja për fëmijën. Gjate përdorimit të ushqimit artificial duhet të jemi të kujdëssem në pastërtin dhe sterilizimin e shisheve, menyren e përdorimit, pozicionin e foshnjës dhe të nënës që te kemi nje ushqyerje të rehatshme. Ushqimi artificial mbetet opsioni i parë që përdoret më se shumti pas ushqimit me gji.

<http://bluzaebardhe.blogspot.com/2013/07/ushqimi-artificial.html>

## 5.2. Përfundimi

Njëri nga veprimet e para për çdo nënë të re apo një nënë e cila është në pritje të fëmijës, me rëndësi është nëse foshnja do të ushqehet me qumësht natyral apo artificial, do të ishte më mirë të vendoset disa kohë para se foshnja të lindë. Ka nëna të cilat me sukses ditë e natë ushqejnë foshnjën e tyre me gji dhe, megjithatë, heqin dorë. Ato janë nëna të cilat nuk kanë besim tek vetja. Ato frikësohen se nuk do të mund të vazhdojnë më shumë dhe vazhdimisht kërkojnë të verifikojnë frikën e tyre. Në qoftë se bebja nganjëherë qan më shumë se zakonisht, mendojnë se nuk kanë qumësht të mjaftueshëm. Në qoftë se bebja ka ngërçe, i dalin puçrra apo ndryshojnë jashtëqitjen, posaçërisht nëse jashtëqitja merr ngjyrë të gjelbër, menjëherë dyshohet tek qumështi i nënës. Shumë nëna heqin dorë nga ushqimi me gji për shkak të thashethemeve se bebja e cila ushqehet me ushqim artificial fiton peshë më të madhe. Ka arsye të ndryshme për mos aplikimin e qumështit të gjirit mirpo është gjithmonë ajo arsyeja kryesore pamundësia për ushqyerjen natyrale që na shtyen deri tek aplikimi i ushqimi artificial, në vitet e fundit na është mundësuar një zgjedhje e kënaqshme për përdorimin e qumështit artificial me të cilin i përmbushim të gjitha kërkesat për foshnjën tonë që të ketë një shëndet të mirë si me ushqyerjen natyrale, asnjë nënë nuk duhet të ndihet keq për shkak të mendimit që nuk do të jete lidhja e njëjtte nëse fëmijën e ushqejm me shishe për shkak se lidhja do krijohet njësojë. Ushqimi i nënës gjithmonë do mbetet me i miri për foshnjën mirpo nëse nuk kemi zgjedhje tjetër duhet të plotësojmë atë me qumësht artificial

<https://ëëë.medial.mk/2018/09/08/perse-disa-nena-nuk-kane-gji-mjaftueshem-per-foshnjat-e-tyre/>

### 5.3.Rekomandimet

Duke u bazuar në të gjithë literaturën e shfletuar rreth ushqimit artificial rekomandojmë

- Nëse nëna nuk mundet ose nuk dëshiron që të japë gjë foshnjës, së pari udhëzohet për qumështin industrial për latant dhe jo përgatitjet në kushte amvisërie të qumështit të lopës nativ ose konsumues.
- Deri në muajin e 4t të jetës më së miri është të përdoret ndonjë prej përgatitjeve industriale të qumështit fillestar për latant (qumësht i adaptuar)
- Mes muajit të 4-6 mund të kalohet në preparate industriale të qumështit të kalimtar (se paku 500 ml) me qrast sigurohet marrja e nevojshme e Ca dhe P.
- Pas muajit të gjashtë mundet që krahas ushqimit të përzier të vazhdohet me përgatitjen e njëjtë industriale të qumështit kalimtar të latantit( ose mundet me qumësht komercial të përgatitur sipas udhëzimeve përkatse)
- Nëse nëna nuk jep gjë, dhe nuk ka mundësi të blerjes të preparateve industriale të qumështit për latant, duhet në rend të parë të udhëzohet për qumësht pluhur komercial për shkak të përparësive ndaj qumështit konsumues të përditshëm
- Nëse prindërit nuk kanë zgjidhje tjetër, përpos qumështit nativ të lopës duhet të kshillohen për higjenën e ruajtjes së qumështit ,higjenën e përgatitjes së tij.

Prof.Asoc.Dr. Mujë Shala Neonatologjia

## 5.4.Referencat

1. **Pediatria Mehmedali Azemi & Mujë Shala me bashkëpuntor**
2. Andereson DH, Williams FH, Merkatz RB.Length of gestation on nutritional composition of human milk.J. Clin. Nutr.1983 ,37:810
3. Beales Pl,Kopelman PG, Obesity genes. Clin. Endocrin.1996;45:373-373
4. Both IW. Clinical nutrition in Pediatrics.J.Sing Paed.Soc 1992; 34:114-120
5. Brown JL. Polli HE. Malnutrition,poverity and intellectual development. Sci.Amer. 1996; 38-43
6. Daniel Bernstein, Steven P Sheller. Pediatrics for medical students, second edition, 2002, 82-90.....
7. Formon S.Nutrition of normal infants, Mosby Publishing, London, 1993.
8. William C. Heird. Nutritional needs of the six to twelve month old infant. Carnation nutrition, Volume 2, New York, 1989, 217-251
9. **Neonatologjia Prof.Asoc. Dr. Mujë Shala**
10. **Manuali Nelson i pediatriis - Kliegman Behrman Jenson Stanton**
11. World Health Organization(WHO) <https://parenting.firstcry.com/articles/bottle-feeding-advantages-and-disadvantages/>
12. ORGANIZATA BOTRORE E SHENDETSIS (OBSH) <http://bebja.com/2016/05/20/sa-dhe-si-duhen-ushqyer-bebat-rekomandime-nga-obsh/>

## 5.5. Biografi e shkurtë e kandidatës (CV)

<b>Informata personale:</b>	
Emri dhe mbiemri	<b>Laureta Muharremaj</b>
Datëlindja	<b>05.08.1996</b>
Gjinia	<b>Femër</b>
Nr. Personal	1234618306
<b>Të dhënat kontaktuese</b>	
Nr. Tel:	<b>+38349655135</b>
Adresa	<b>Pejë</b>
Emaili	<a href="mailto:laureta.muharremaj@hotmail.com">laureta.muharremaj@hotmail.com</a>
<b>Të dhënat e kualifikimit</b>	
Shkolla e mesme e lartë	<b>SH.M.Mjekësisë “Ramiz Sadiku”</b>
Universiteti	<b>Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”</b>
Fakulteti	<b>Fakulteti i Mjekësisë</b>
Programi	<b>Mami</b>
Statusi	<b>E rregullt</b>
Nr. ID	<b>150305034</b>